



UNMIK

UNMIK/REG/2001/1
12 janar 2001

RREGULLORJA NR. 2001/1

**MBI NDALIMIN E GJYKIMEVE NË MUNGESË PËR THYERJE SERIOZE TË
LIGJIT HUMANITAR NDËRKOMBtar**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,
Në pajtim me autoritetin që i është dhënë me rezolutën 1244 (1999) të 10 qershorit 1999,

Duke e marrë parasysh rregulloren nr. 1999/1 të 25 korrikut 1999 të Misionit të Përkohshëm
Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe amandamentet e bame me
autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë.

Duke e marrë parasysh natyrën ofenzive të thyerjeve të ligjit humanitar dhe nevojën e veçantë
për me e siguru administrimin e duhur të drejtësisë në rastet kur janë kryer asi lloj krimesh.

Duke i marrë parasysh të drejtat e të akuzuarit dhe veçanërisht të drejtën për gjykim të drejtë.

Promulgon të maposhtmet:

Neni 1

Ndalimi i Gjykimeve në Mungesë për Thyerje të Ligjit Humanitar Ndërkombtar

Asnjë person nuk mund të gjykohet në mungesë për thyerje serioze të ligjit humanitar
ndërkombtar, ashtu si është definu në Kapitullin XVI të ligjit në përdorim të Kodit Kriminal
të Jugosllavisë ose në Statutin e Romës të Gjyqit Kriminal Ndërkombtar (17 korrik 1998).

Neni 2

Ligji në Përdorim

Rregullorja e tashme do t'i tejkalojë të gjitha provizionet tjera në ligjin në përdorim që nuk
përkojnë me te.

Neni 3

Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë udhëzime administrative për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 4
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me 12 janar 2001 dhe vlen edhe për ato procedime kriminale që janë duke pritë me u zgjedhë, prej të njejtës datë.

Bernard Kouchner
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm